



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 473/5 Prot

Tiranë, më 15.10.2020

V E N D I M

Nr.124, datë 15.10.2020

Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar në bazë të kërkesës së paraqitur nga punonjësi *** , për parregullsi të kryera gjatë lirimimit të tij nga detyra e “Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm”, në Bashkinë Klos.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet për parregullsi të kryera gjatë lirimimit të punonjësit ***** nga detyra e “Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm”, në Bashkinë Klos,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 473 prot., datë 29.05.2020, shtetasi ***** , ngre disa pretendime për parregullsi të lejuara gjatë kryerjes së procesit të lirimimit të tij nga detyra e “Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm”, në Bashkinë Klos, veprime të cilat vijnë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Konkretisht, në ankesë parashtrohet se, me shkresën nr. 2607 prot., datë 11.11.2019, prej punonjësit në fjalë është kërkuar “Dorëheqja nga detyra e Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm”, në Bashkinë Klos dhe në vijim, me vendimin nr. 122 prot., datë 15.11.2019, të

Kryetarit të Bashkisë Klos, është vendosur lirimi i këtij punonjësi nga detyra e mësipërme, ndërprerja e marrëdhënieve financiare, bazuar në kërkesën e tij, si dhe është ngarkuar “Drejtoria e Burimeve Njerëzore” për zbatimin e këtij vendimi.

Në mbështetje të sa më lart, punonjësi ***** pretendon se, vendimi nr. 122 prot., datë 15.11.2019, marrë nga Kryetari i Bashkisë Klos, i cili ka vendosur lirimin nga detyra e Përgjegjësit të Sektorit të Auditit, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Sipas tij ai është punësuar rregullisht pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, në pozicionin e punës “Specialist në Sektorin e Auditit”, në Bashkinë Klos, ku në përfundim është shpallur fitues, në datën 31.03.2017. Në pozicionin “Përgjegjës i Auditit të Brendshëm”, ai ka qenë i komanduar dhe njësia e burimeve njerëzore, duhet ta kishte kaluar në pozicionin e tij të punës si “Specialist i Auditit të Brendshëm”, ku është shpallur fitues pas konkurrimit, dhe jo të ndërpriste marrëdhënien e punës me institucionin.

Për verifikimin e këtyre pretendimeve, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 473/1 prot., datë 15.06.2020, me objekt: “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e ankesës së punonjësit *****”, kërkoi nga institucioni Bashkia Klos, sqarime si dhe praktikën shkresore që materializon këtë procedurë administrative.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Klos, me shkresën nr. 1400/2 prot., datë 22.06.2020, me objekt: “Kthim përgjigje”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 473/2 prot., datë 24.06.2020, ka paraqitur sqarimet si dhe dokumentacionin e kërkuar për rastin në fjalë.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së sqarimeve të dhëna si dhe dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar e vërtetuar se, punonjësi ***** bazuar në njoftimin e Bashkisë Klos, datë 31.01.2017, për “Shpalljen e pozicioneve të lira të punës (Specialist Auditit në Sektorin e Auditit të Brendshëm)”, ka aplikuar në procedurën e pranimit në shërbimin civil për pozicionin e mësipërm në këtë institucion, nga ku rezulton se në përfundim të konkurrimit është shpallur fitues me 85 pikë. Në vijim të përmbylljes së kësaj procedure, këtij punonjësi i është kërkuar që brenda datës 21.04.2017, të paraqitej në Bashkinë Klos për të nënshkruar deklaratën e fituesit e të fillonte marrëdhënien e punësimit. Nga dokumentacioni vënë në dispozicion prej Bashkisë Klos, rezulton se punonjësi ***** në deklaratën e fituesit për zgjedhjen e pozicionit datë 21.04.2017, ka refuzuar pranimin e pozicionit “Specialist Auditit” (opsioni 2), duke preferuar të qëndrojë në listën fituese për një periudhë 2 vjeçare(periudhë e cila ka përfunduar në datën 21.04.2019).

Më pas, me vendimin nr.37 datë 17.05.2017 “Për emërim të përkohshëm”, e Kryetarit të Bashkisë Klos punonjësi ***** (pavarësisht se në listën e pritjes ishte në pritje për një pozicion në kategorinë ekzekutive) është emëruar përkohësisht në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm”, detyrë të cilën e ka kryer deri në datën 15.11.2019.

Duke vlerësuar ligjshmërinë e veprimit të mësipërm administrativ, konstatohet që vendimi nr. 37 datë 17.05.2017 i Kryetarit të Bashkisë, ka dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22 dhe 23 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm (pika 4, e nenit 23, të ligjit). Duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, e bën aktin absolutisht të pavlefshëm.

Si rrjedhojë, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk mund të prodhojë një marrëdhënie në shërbimin civil, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Klos, duhet të konstatonte në këtë veprim administrativ, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 113, të po këtij ligji, të bënte anulimin e aktit administrativ të cituar më sipër. Në bazë të nenit 113, pika 2, e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, anulimi i aktit ka pasoja edhe për të shkuarën, dhe për rregullimin e ligjshmërisë së këtyre rasteve, duhet që gjithë procedura për plotësimin e këtyre pozicioneve të punës, të fillojë nga e para, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në këto kushte, kërkesa për dorëheqje bërë me shkresën nr. 2607 prot., datë 11.11.2019, prej punonjësit *****, i ka dhënë fund një marrëdhënie të zakonshme kontraktore të punës e për rrjedhojë nuk mund të ketë asnjë efekt në marrëdhëniet e shërbimit civil.

Pretendimi i kërkuesit në fjalë, se në rastin konkret Njësia Përgjegjëse duhej të ndërpriste marrëdhënien e punës si “Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm” dhe ta kalonte në pozicionin “Specialist i Auditit të Brendshëm” ku kishte fituar konkurrimin, nuk mund të pranohet.

Koha e qëndrimit prej dy vjetësh në listën e pritjes, pas refuzimit të fillimit të marrëdhënies së punës në pozicionin ku kishte fituar konkurrimin, siç u tha dhe më lart, ka përfunduar në dt. 21.04.2019, kështu që njësia përgjegjëse e kishte të pamundur ta kalonte kërkuesin në pozicionin e pretenduar.

Megjithatë, në përfundim të konstatimeve të evidentuara më sipër dhe në referencë të dispozitave të sipërpërmendura, vlerësoj se vendimi nr. 122 prot., datë 15.11.2019, marrë nga

Kryetari i Bashkisë Klos, i cili ka vendosur *“Lirimin nga detyra e Përgjegjës të Sektorit të Auditit”*, pavarësisht motivit, formës dhe rrethanave, nuk është i paligjshëm, pasi në thelbin e tij është respektuar fryma e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, i cili në këtë rast kërkon ndërprerjen e gjendjes së paligjshmërisë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të ankesës nr. 473 prot., datë 29.05.2020, të paraqitur nga punonjësi ***** , për parregullsi të pretenduara se janë kryer gjatë lirimimit të tij nga detyra e *“Përgjegjës të Auditit të Brendshëm”*, në Bashkinë Klos dhe mos emërimin e tij në pozicionin e punës *“Specialist i Auditit të Brendshëm”*, pasi nuk u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore e nënligjore që rregullojnë shërbimin civil dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Bashkia Klos dhe punonjësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha